

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje shërbim printimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Printime dhe shërbime të lidhura

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,890,666 (dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Posta Shqiptare” SHA**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti ynë kontraktor, ka zbatuar parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publike”, neni 49 si dhe në nenin 55 të Kreut VI të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” i ndryshuar, kjo pasi *specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te Autoritetit Kontraktor*

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, neni 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neni

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

(Kërkesa e lartpërmëndur do i shërbejë autoritetit kontraktor si tregues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kjo në përputhje me nenin 77 të LPP dhe nenin 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Operatori ofertues duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 19% të vlerës limit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 (a) Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente; Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë).

(Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të shërbimit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.)

(b) Çertifikatë ISO 27001:2013 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë informatike” ose ekuivalente me të. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Ky kriter është përcaktuar për arsye se ISO 27001, është një standard që rregullon sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra ka të bëjë me teknologjinë e informacionit. ISO 27001:2013 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshatatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurt).

(c) Certifikate ISO 20000-1:2011 mbi “Sistemet e menaxhimit te shërbimit” ose ekuivalente me të. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Objekti i kontratës kërkon shërbim për pajisjet IT për shërbimin e printimit. Në mënyrë që OE të provojë aftësinë e tij në ofrimin e shërbimit nevojitet certifikata e mësipërme.)

2.3.3 OE duhet të paraqesë një projekt ku detajohet zgjidhja teknike dhe mënyra e menaxhimit të shërbimit të printimit.

Kriteri i vendosur garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë për autoritetin kontraktor besim, siguri dhe garanci për cilësinë e pajisjeve të sigurisë të cilat shërbejnë për të realizuar objektin e prokurimit, Shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a siç kërkohet në Shtojcën 8 - Specifikimet teknike.

2.3.4. OE duhet të paraqesë katalogë për HW & SW të ofruar. Katalogët duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar.

Kërkesa e lartpërmendur do t’i shërbejë autoritetit kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., për të vërtetuar se mallrat e ofruara prej Operatoreve Ekonomik plotësojnë kërkesat e çelësisë, origjinalitetin e mallrave kjo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 46 pika 2 si dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, nenin 27 paragrafi 6 pika b dhe c, të cilat do t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar origjinalitetin e mallrave , përshkrimin dhe/ose katalogjet teknike, si dhe për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të lëshuara nga institucione të autorizuar..

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 5 (pesë) teknikë të certifikuar nga prodhuesi **ose ekuivalent** për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, nga të cilët:

- 2 prej tyre inxhinierë elektronikë;

(Ky kriter bazohet në VKM 514 datë 20.09.2017 Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesionevë (LKP), të rishikuar” i cili për profesionin Inxhinier Elektronik parashikon se:

Inxhinierët elektronike kryejnë studime, dizajnojnë ose drejtojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparojnë sistemet elektronike dhe studiojnë e këshillojnë mbi aspektet teknologjike të materialeve, produkteve apo proceseve inxhinierike elektronike. Nder detyrat e tyre kryesore përfshihen:

Këshillojnë mbi ose dizajnojnë pajisje elektronike ose komponentë, qarqe, gjysmë-përçues dhe sisteme;

b) Specifikojnë prodhimin dhe metodat e instalimit, materialet dhe standardet e cilësisë dhe drejtojnë prodhimin ose punën e instalimit të produkteve dhe sistemeve elektronike;
c) Përcaktojnë standardet dhe procedurat e kontrollit për të siguruar funksionim eficient dhe të sigurtë të sistemeve elektronike, motorëve dhe pajisjeve;

- 1 (një) inxhinier i certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe konfigurimin e software-it të menaxhimit të printimeve.

(Sherbimi i printimit përmban një software i cili kryen menaxhimin e të gjitha pajisjeve të cilat do të jenë pjesë e shërbimit të printimit. Nevojitet të paktën një specialist i cili do të mirëmbajë dhe menaxhojë këtë sistem gjatë periudhës së shërbimit.)

- 1 (një) inxhinier i certifikuar me titullin MCSE **ose ekuivalent**

(Në ambientin ku do të kryhet mirëmbajtja ekzistojnë mbi 40 servera me sistem operimi Windows dhe disa instanca Database MS SQL Server çka sjell nevojën për një ekspert për sistemet e prodhuara nga kompania Microsoft aftësitë e të cilit vërtetohen nëpërmjet certifikimit MCSE.)

- 1 (një) punonjes i certifikuar për menaxhim projekti ITIL ose ekuivalente.

(Meqë produktet e këkuara në këtë procedurë shërbejnë për të ruajtur dhe shërbyer sistemet Core të AK, si dhe bazuar në numrin e madh të pajisjeve të cilat do të jenë në mirëmbajtje, nevojitet një punonjës i kualifikuar i cili ka njohuri shumë të mira për implementimin dhe menaxhimin e sistemeve IT cilësi të cilat vërtetohen nëpërmjet certifikimit ITIL.)

- 1 (një) punonjes të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit.

(Shërbimi i printimit ka në qendër të arkitekture së vet serverin e printimit, ku është instaluar software i cili kryen menaxhimin e të gjitha pajisjeve të cilat do të jenë pjesë e shërbimit të printimit. Nevojitet të paktën një specialist i cili do të instalojë një soft të ri në bazë të teknologjise që ofrohet ose do të menaxhojë të njëjtin soft që perdoret aktualisht.)

Këto duhet të vërtetohen me kontratën individuale të punës, dhe të jenë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore sipas formatit E-sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi për periudhën Shtator 2023 – Dhejtor 2023.

**(sqarim: Lidhur me certifikimet, një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin)*

2.3.6. Operatori Ekonomik i cili ofron këtë zgjidhje duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose leter angazhimi ose akt marrëveshje bashkëpunimi, midis prodhuesit/ve ose distributorit dhe OE ofertues, për software të menaxhimit të printimeve. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

(Ky kriter vendoset për të vertuar që OE është i autorizuar nga prodhuesi për të prokuruar shërbimin objekt prokurimi, në respektim të mënyrave të parashikuara nga LPP, me qëllim që artikujt e kërkuar të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe cilësore të kërkuara).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, objektin të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve të reja (përfshirë virtualizimin) dhe shërbimeve të migrimit, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

- 1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga struktura e posacme e ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor

Njësia e Prokurimit